



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 12-104-02-22748-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

13.08.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

Kabineti i Kryetarit të Komunës

DATA	13.08.2025
Për:	Kryesuesen e Kuvendit Komunal, Vlora Mjekiqi - Kabashi .
Përmes:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës
Nga :	Antigona Morina, Udhëheqëse e NJBNJ .
LËNDA	Kërkesë

Nga ju kërkojmë që të prezantoni ne mbledhjen e radhës të KPF-se marrjen e vendimit për miratim të Rregullores për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Obiliqit.

Grupi punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Obiliqit i cili është emëruar nga Kryetari i Komunës me dt.01.11.2024 me Nr.të Vendimit 02/110-03-34106/24 duke u mbështetur në propozimet dhe bashkëpunim me drejtoritë komunale ka përfunduar draft Rregulloren për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.

Grupi punues me datën 12.03.2025 përmes emailit zyrtar draftin fillestar të Rregullores për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës e ka dërguar për mendim juridik në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik. Me datën 27.03.2025 përmes emailit zyrtar kemi pranuar mendimin këshillimor nga DMZP lidhur me draft Rregulloren për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.

Grupi punues draft Rregulloren për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës e ka nxjerr në diskutim publik me dt.25.06.2025. Diskutimi publik ka qenë i hapur 15 ditë nga data 25.06.2025 deri me dt.10.07.2025 kur edhe është mbajtur takimi për tu diskutuar Draft Rregullorja për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.

Të bashkangjitur gjeni draft Rregulloren për Organizimin e Brendëshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.

Me respekt !